

01.03.2022

Ora 17:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e rregullave procedurale teknike dhe të modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdoren nga KZAZ 26, Bashkia Vorë, Qarku Tiranë, për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Iirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini, E.Meta**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**


Z. I. Celibashi: Mirëmbërëma! Në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje:

projektvendim “Për miratimin e rregullave procedurale teknike dhe modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdoren në KZAZ 26, Bashkia Vorë për administrimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të votimit dhe numërimit elektronik”;

projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së televizionit Top Chanel për vëzhgimin e zgjedhjeve të 6 marsit”;

kemi një projektvendim që lidhet me tërheqje vëmendjeje ndaj televizionit të Koplikut, TV Kopliku, për pasqyrën e fushatës elektorale nga ky televizion;

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.03.2022*

pika e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesave “Për akreditim të vëzhguesve nga disa përfaqësi diplomatike të akredituara në Tiranë”;

pika e pestë është projektudhëzimi për përdorimin e aplikacionit të KQZ.

Mirë, atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me procedurat, miratimin e procedurave, rregullat proceduriale dhe modelet e dokumentacionit të punës për zgjedhjet në Bashkinë Vorë.

Z. E. Meta: Në zbatim të vendimit të Komisionit Rregullator për të përcaktuar rregullat e aplikimit të projektit pilot në KZAZ 26, në Bashkinë Vorë, del imediate hartimi i rregullave udhëzuese dhe operacionale për aplikimin dhe implementimin e projektit pilot të votimit dhe numërimit elektronik të votave në këtë KZAZ. Bashkëlidhur ndodhen rregullat operacionale, modelet e punës me të cilat do të punojnë komisionet e qendrave të votimit dhe komisioni zonal i administratës zgjedhore në këtë KZAZ.

Z. I. Celibashi: Në rregull! Nga përfaqësuesit e partive s’kemi patur ndonjë koment në lidhje me këtë projektakt. Mirë, dakord, atëherë miratojmë projektaktin sipas draftit të paraqitur, të propozuar.

Vendim nr. 110

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



01.03.2022
Ora 17:39

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së TV Top Channel për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini, E.Meta**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e dytë që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së televizionit Top Chanel, për akreditimin e vëzhguesve për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Shkurtimisht, Ermina!

Znj. E. Allushi: Televizioni Top Chanel i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 117 gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesa e paraqitur është jashtë afatit të përcaktuar në pikën 11, të Kodit, të vendimit nr.2, datë 2022 të Komisionit Rregullator. Megjithatë kjo nuk e përjashton, vendimmarrja juaj!

Z. I. Celibashi: Mirë, edhe pse kërkesa është paraqitur jashtë afatit dhe duke qenë se këto afate nuk janë afate prekluzive dhe në kushtet, kur nuk afekton administrimin

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.03.2022*

e procesit zgjedhor dhe punën e KQZ-së për përgatitjen e këtyre zgjedhjeve, do ta miratojmë këtë kërkesë, por duke sjellë në vëmendje të këtij televizioni, por edhe në përgjithësi disa mediave të tjera, detyrimin për t'i respektuar qoftë dhe formalisht afatet që janë vendosur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, veçanërisht ato që lidhen me paraqitjen e kërkesave për vëzhgimin e zgjedhjeve.

Atëherë miratohet kërkesa për akreditimin e 117 gazetarëve dhe operatorëve të televizionit Top Chanel për vëzhgimin e zgjedhjeve të 6 Marsit 2022.

Vendim nr. 111

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



01.03.2022
Ora 17:41

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për tërheqje vëmendje ndaj TV Koplikut për transmetim reklamash jashtë intervaleve kohore”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E. Allushi, V.Ballgjini, E.Meta**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Pika e tretë ka të bëjë me një vendimmarrje që lidhet me pasqyrën e fushatës zgjedhore nga televizioni TV Kopliku. Po, Valbona!

Znj. V. Ballagjini: Referuar nenit 84, pika 7 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon intervalet kohore të transmetimit të reklamave nga subjektet politike, ku parashikohen oraret 15:00 – 18:00, dhe ora 21:00 - 24:00, duke qenë që Autoriteti i Mediave Audiovizive është monitoruesi i sjelljeve politike për partitë politike, për fushatën zgjedhore në media, ka dorëzuar raporte në të cilat rezulton se TV Kopliku nuk ka respektuar këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor, prandaj AMA i propozon KQZ-së t’i kërkojë kësaj OSHMA-je ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë intervalit kohor të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Respektivisht janë përcaktuar disa data nga AMA, që janë datat 26, 27 dhe 28 shkurt, nga raporti i

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.03.2022*

AMA-s për datat 25, 26 dhe 27 shkurt. Për sa më sipër në mbështetje të nenit të sipërcituar, ju propozojmë miratimin e tërheqjes së vëmendjes kundrejt OSHMA-së së raportuar nga AMA. Faleminderit!


Z. I. Celibashi: Në rregull, dakord, e miratojmë projektaktin sipas draftit të paraqitur duke i tërhequr vëmendjen televizionit TV Kopliku, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë fashës së orarit të përcaktuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e tij në KAS.

Vendim nr. 112

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës të Ambasadës së Francës, Polonisë, Sllovenisë, Kroacisë, Spanjës dhe Gjermanisë për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :


- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini, E.Meta**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e katërt, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesave të disa prej përfaqësive diplomatike të akredituara në Tiranë për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 6 Mars 2022. Kemi kërkesë nga Ambasada e Francës, Ambasada e Polonisë, Ambasada e Sllovenisë, Ambasada e Kroacisë, Ambasada e Mbretërisë së Spanjës dhe Ambasada e Gjermanisë. Nuk kemi ndonjë problem me dokumentacionin, jemi në rregull?

Znj. E. Allushi: Jo! Respektojnë afatin kohor dhe dokumentacioni është i rregullt.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, atëherë miratohet akreditimi i 7 vëzhguesve afatshkurtër dhe i 5 përthyesve të Ambasadës Franceze;

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.03.2022*

akreditimi i një vëzhguesi afatshkurtër të Ambasadës së Polonisë;
akreditimi i një vëzhguesi afatshkurtër të Ambasadës së Sllovenisë;
akreditimi i dy vëzhguesve afatshkurtër dhe një përkthyesi të Ambasadës së Kroacisë;
akreditimin e një vëzhguesi afatshkurtër të Ambasadës së Mbretërisë së Spanjës;
akreditimin e katër vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 përkthyesve të Ambasadës së Gjermanisë. Këto janë të gjitha!

Vendim nr. 113

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



01.03.2022
Ora 17:45

RENDI I DITËS

Projektudhëzim “Për përdorimin e aplikacionit “KQZ” në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini, E.Meta**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e fundit e rendit të ditës. Projektudhëzimi “Për përdorimin e aplikacionit “KQZ”, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars”. Po Erion, shkurtimisht!

Z. E. Meta: Me qëllim manaxhimin e integruar të informacionit nga administrata zgjedhore, para datës së zgjedhjeve, gjatë ditës së zgjedhjeve dhe pas saj, është ana e domosdoshme përdorimi i aplikacionit “KQZ” për administrimin e informacioneve dhe problematikave që i hasin administratës zgjedhore, gjatë ditës së votimit. Nëpërmjet aplikacionit “KQZ”, anëtarët e komisionit të qendrës së votimit, KZAZ-ve dhe sipas rasteve dhe operatorët, mund të informojnë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve duke raportuar për dorëzimin e bazës materiale, vendimmarrjet të tyre, ecurinë e votimit dhe ecurinë e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve të votave. Është përcaktuar në projektakt që operatori i PEI-t dërgon çdo një orë, duke filluar

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.03.2022*

nga ora 07:00 e ditës së votimit, informacionin mbi pjesëmarrjen nëpërmjet një *QR Code*, duke skanuar *QR-Code*, sipas procedurave të përcaktuara në dokumentin e detajuar që ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord! Edhe këtë projektakt e miratojmë sipas draftit të paraqitur.

Udhëzim nr. 2

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 01.03.2022*

Z. I. Celibashi: Janë të dyja ndërtesa publike?

Z. E. Meta: Ndërtesa publike dhe vendndodhje me një distancë shumë të ngushtë.

Z. I. Celibashi: Edhe ndërkohë venë si vendndodhje atje ku kanë qenë zgjedhjet e 25 prillit 2021. Në rregull atëherë, miratojmë edhe këtë projekvendim. Çështje tjera në rendin e ditës nuk kemi! Para se ta mbyllim dua publikisht të sjell në vëmendje një shqetësim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ka të bëjë me zhvillimin e trajnimit të komisionerëve. Vazhdojmë që të kemi të njëjtën situatë problematike, sikurse dhe në zgjedhjet e shkuara. Kemi një mungesë të theksuar të interesimit të partive politike për të nxitur anëtarët, të cilët i kanë propozuar për komisionerë, për të marrë pjesë në seancat e trajnimit. Ndaj gjej rastin që t'u bëj një thirrje partive politike për t'u angazhuar në këtë proces, në raport të drejtë me përgjegjësitë dhe të drejtat që ato kanë, veçanërisht me të drejtat që ato kanë në procesin zgjedhor, pasi është shumë e rëndësishme që ata të cilët do të administrojnë zgjedhjet, të marrin trajnimin e duhur nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi kështu procesi zgjedhor do të përmbushë të gjitha standardet që lidhen me legjitimitetin e këtij procesi, dhe duhet të vazhdojmë që t'i nxisim partitë për t'u përfshirë seriozisht dhe realisht në këtë proces. E mbyllim seancën! Faleminderit, natën e mirë!

Vendim nr. 114

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

